



Albania • Shqipëria


Assistance in Implementing the Aarhus Convention
Mbështetje për zbatimin e Konventës së Aarhusit



QENDRA RAJONALE E MJEDISIT
për Evropën Qendrore dhe Lindore



 Vendet që kanë nënshkruar Konventën e Aarhusit.

 Vendet që e kanë ratifikuar ose miratuar Konventën e Aarhusit.

(Shënim: Nuk janë paraqitur gjithë vendet e rajonit të UNECE.)

FOLLOW-UP ACTIVITIES

- The strategy and action plan for implementation of the Aarhus Convention will be promoted to target groups at the local level, i.e. to local authorities, communities and groups.
- Capacity-building activities will continue, with more focus on access to justice, environmental monitoring, pollution release and transfer registers and decision making about GMOs.
- Efforts will be supported to implement public participation at all levels. This activity will target specific processes such as environmental impact assessment, the development of regional strategies and plans and law drafting.
- Materials about the convention will be published, including European Union's directives and legislation.

HISTORIK

Shqipëria e ka nënshkruar Konventën e Aarhusit në 25 qershor 1998. Kuvendi i Shqipërisë e ka ratifikuar në 26 tetor 2000. Para ratifikimit, janë kryer mjaft aktivitete për rritjen e shkallës së njohjes të Konventës dhe për zbatimin e saj në praktikë. Qendra Rajonale e Mjedisit (REC) për Europën Qendrore e Lindore ka qenë një nga organizatat më aktive në këtë proces, duke mbështetur e lehtësuar aktivitetet në kuadër të projektit "Mbështetje për hartimin e strategjive për zbatimin e Konventës së Aarhusit".

AKTIVITETET

- Takime rajonale mbi detyrimet e autoriteteve vendore: Pjesëmarrësit janë njohur me rolin e tyre për zbatimin e Konventës së Aarhusit, sipas kuadrit ligjor, miratuar nga Kuvendi gjatë vitit 2002.
- Strategjia për zbatimin e Konventës së Aarhusit: dy grupe pune: një me përfaqësues të strukturave qeveritare dhe një me përfaqësues të OJF-ve kanë përgatitur strategjinë për zbatimin e Konventës së Aarhusit.
- Mbështetje për Qendrën e Informacionit të Ministrisë së Mjedisit: është organizuar një vizitë studimore në Hungari, për specialistë dhe përfaqësues të Bashkisë së Tiranës, OJFve, Ministrisë së Mjedisit.
- Komente mbi projekt ligjet dhe dokumente të tjera strategjike: Janë organizuar pesë tryeza pune për përfaqësues të OJF-ve, qeverisë dhe Kuvendit të Shqipërisë.
- Kurse Trajnimi mbi parimet dhe mekanizmat e Konventës së Aarhusit: anëtarë të OJF-ve, zyrtarë të Ministrisë së Mjedisit e të qeverisë dhe autoritete të tjera publike janë kualifikuar mbi zbatimin në praktikë të Konventës së Aarhusit.
- E drejta për t'iu drejtuar gjykatës sipas Konventës së Aarhusit: botimi përshkruan shtyllën e tretë të Konventës, kuadrin ligjor shqiptar dhe raste studimore nga vendet të ndryshme.

PËRFUNDIMET KRYESORE TË STRATEGJISË

- Kuadri ligjor: Shqipëria ka një kuadër ligjor mjedisor të ri, që pasqyron kërkesat e Konventës. Megjithatë, është e nevojshme që ai të plotësohet me akte nënligjore, procedura dhe rregullore për zbatimin në praktikë.
- Kuadri institucional: Institucionet dhe autoritetet publike nuk kanë ende përgjegjësi të qarta për përfshirjen e publikut. Këto duhet të përcaktohen për institucionet publike në të gjitha nivelet. Procedurat për informimin e publikut duhet të standardizohen, ndërsa duhen përmirësuar kapacitetet institucionale.



- Forcimi i kapaciteteve: as autoritetet dhe as publiku nuk janë të ndërgjegjësuar sa duhet për detyrimet dhe të drejtat e tyre që rrjedhin nga Konventa e Aarhusit dhe legjislacioni shqiptar.

ARRITJET

- Është përgatitur Strategjia dhe Plani i veprimit për zbatimin e Konventës së Aarhusit.
- Ka filluar një proces diskutimi për aktet ligjore e dokumentet strategjike, gjatë përgatitjes së tyre, që është vlerësuar si i dobishëm nga të gjithë aktorët.
- Janë trajnuar përfaqësues të OJF-ve, të institucioneve qeveritare e të subjekteve të tjera, lidhur me Konventën dhe çështje specifike të saj në Shqipëri.
- Janë përgatitur publikime të dobishme dhe interesante: fletë informative, broshurë “E drejta për t’iu drejtuar gjykatës sipas Konventës së Aarhusit” dhe një poster.
- Mbështetje konkrete për Qendrën e Informacionit të Ministrisë së Mjedisit për botimin e buletinit të Ministrisë “Mjedisi Shqiptar”, që paraqet informacione mbi kuadrin ligjor dhe aktivitete për pjesëmarrjen publike.

VAZHDIMËSIA

- Strategjia dhe Plani i veprimit për zbatimin e Konventës së Aarhusit do të promovohen për grupe të synuara në nivel vendor: autoritete vendore, grupe dhe komunitete.
- Aktivitetet për forcimin e kapaciteteve do të vijojnë, duke u përqëndruar më shumë në të drejtën për t’iu drejtuar gjykatës, monitorimit të mjedisit, rregjistrat e shkarkimit dhe transferimit të ndotësve dhe vendimmarrjen mbi OMGJtë.
- Do të vijojnë të mbështeten përpjekjet për pjesëmarrje publike në të gjitha nivelet. Këto aktivitete do të synojnë procese të veçanta, si vlerësimi i ndikimit në mjedis, hartimi i strategjive, planeve rajonale dhe ligjeve të reja.
- Do të botohen materiale mbi konventën dhe, sidomos, direktivat dhe kuadri ligjor evropian që lidhet me të.

